

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-133/12

**Prishtinë,
15 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

A. R., H. R., I. R., B. R.

Komuna e Klinës

Më tej, të gjithë referohen si:

Palët ankuese

kundër.

D. P.

19219 Belgrade/Borca Serbia

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2011 (lëndët të regjistruara në AKP me numrat 14555 dhe 14556), të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 15 prill 2014, mori këtë

AKTGJYKIM:

1. Ankesat janë të bazuara;
2. Ndryshohet vendimi i KKKP-së KPCC/D/A/126/2011 i datës 26 tetor 2011 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrat 14555 dhe 14556;
3. Hedhen poshtë si të papranueshme kërkesat e regjistruara në AKP me numrat 14555 dhe 14556.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 nëntor 2006 D. P. paraqiti dy kërkesa, të regjistruara me numrat AKP 14555 dhe 14556, pranë Agjencisë Kosovare të Pronës duke kërkuar ri-posedimin e pronave (më tutje të gjitha referohen si prona) të listuara në Fletën Poseduese nr. 14, e lëshuar me datë 16 shtator 2003 nga Shërbimi Kadastral i Palujtshmërive i Komunës së Klinës, siç vijon:

Vendi	ngastra nr	kultura	klasa	sipërf. ha	Nr. AKP	GSK-KPA-A-nr.
Zelenilo	175/1	livadh	1	00.46.33	14556	133/12
Zelenika	175/2	pemishte	1	00.34.04	14556	133/12
Zelenika	175/3	arë	2	00.07.60	14556	133/12
Zelenika	175/3	oborr	2	00.02.00	14556	133/12
Zelenika	175/4	arë	2	00.55.38	14556	133/12
Selo	172/1	pemishte	3	00.09.96	14555	132/12
Selo	172/2	pemishte	3	00.09.26	14555	132/12
Selo	173	pemishte	3	00.13.47	14555	132/12
Selo	174	pemishte	2	00.03.80	14555	132/12

2. Njoftimi fizik i pronës është kryer nga AKP me 17 prill 2008 (AKP 14555) dhe më 17 dhjetor 2008 (AKP 14556).

3. Njoftimi i pronës nëpërmjet publikimit është bërë më 30 korrik 2010. Raportet e njoftimit dhe të konfirmimit të të dy kërkesave (AKP 14555 dhe 14556) cekin se prona e kërkuar është: *“komerciale pa*

objekte” ndërsa AKP14555 thekson: “Prona është përmishte e dëmtuar”, dhe AKP 14556: “prona është përmishte dhe tokë e papunuar”.

4. Njoftimi i pronës nëpërmjet publikimit është bërë më 30 korrik 2010. Hollësitë për pronën, të dhëna në një listë dhe në një udhëzim për procedurën, janë publikuar dhe shpërndarë si shtojcë në të përditshmen Koha Ditore dhe në ueb faqen e AKP-së. Njoftimi për këto dy dokumente është publikuar në dy gazeta ditore. Lista është vendosur në zyrën e AKP-së në Pejë, në ndërtesën e komunës, gjykatën komunale, dhe në zyrën kadastrale të Klinës. Njoftimi i kërkesës i është dërguar të parit të fshatit si dhe është vendosur në hyrje dhe dalje të fshatit.

5. Kërkesat ishin vendosur nga KKPK si të pakontestuar në vendimin e datës 26 tetor 2011, nr. KPCC/D/A/126/2011. Ishte vendosur se D. P. kishte dëshmuar se ai ishte pronari i vetëm i pronës. Gjithashtu, ishte vendosur që çdo person që e kishte uzurpuar pronën duhej ta lironte atë brenda 30 ditësh nga dorëzimi i vendimit.

6. Vendimet iu dorëzuar palëve ankuese më 9 tetor 2012.

7. Palët ankuese paraqitën ankesat kundër vendimeve të KKPK-së pranë AKP-së më 16 tetor 2012, që është brenda periudhës prej 30 ditësh të cekur në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).

8. D. P. ka paraqitur përgjigjen në ankesë më 4 dhjetor 2012.

Bashkimi i ankesave:

9. Neni 408.1 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) parasheh se gjykata mund t'i bashkojë të gjitha lëndët ku dy apo më shumë procedura janë në zhvillim e sipër në të njëjtën gjykatë dhe që përfshijnë personat e njëjtë, nëse me një gjë të tillë do të sigurohej efektshmëria e gjykatës dhe efikasiteti i lëndës.

10. Në lëndët e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-133-134/13 (AKP 14555 dhe 14556), faktet, baza ligjore, dhe çështjet e vërtetimit të provave janë të njëjta. Vetëm ngastrat, që janë objekt i së drejtës pronësore së kërkuar në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në të njëjtën deklaratë sqaruese dhe në të njëjtin dokumentacion. Pasi që të gjitha elementet e gjertanishme të këtyre lëndëve janë të njëjta përveç ngastrave, qartazi është më efikase që të bashkohen lëndët dhe ato të shqyrtohen në një aktgjykim të vetëm.

11. Me një urdhër të datës 8 mars 2013, Gjykata Supreme ka vendosur t'i bashkojë këto dy lëndë GSK-KPA-A-133/12 dhe GSK-KPA-A-134/12, tani të regjistruara bashkë si: GSK-KPA-A-133/12.

12. Gjykata Supreme ka lëshuar një urdhër për palët ankuese si dhe palën përgjegjëse në ankesë më datën 8 mars 2013. Ky urdhër i është dorëzuar palëve ankuese më 25 mars 2013 dhe palës përgjegjëse në ankesë më datën 10 korrik 2013.

13. Palët ankuese kanë paraqitur përgjigjen më 3 mars 2013, ndërkaq pala përgjegjëse në ankesë nuk ka paraqitur përgjigje.

14. Gjykata Supreme ka lëshuar një urdhër për AKP-në më 25 tetor 2013 së cilës AKP i ka kthyer përgjigje më 12 nëntor 2013 (kësaj përgjigjeje më tej i referohet si memorandum).

15. Më 3 korrik 2008 është bërë një raport verifikues nga AKP që theksonte se sipas fletës poseduese nr. 14 prona është regjistruar në emër të V. P., nënës së ndjerë të D. P.

16. Sipas aktvendimit mbi trashëgiminë të Gjykatës Komonale në Pejë, të datës 3 prill 1996, (nr.O.br.30/96) D. P. ka trashëguar tërë pronën duke qenë trashëgimtari i vetëm i V. P.

17. Në paragrafin 14 të urdhrit të lartcekur të datës 25 tetor 2013 të Gjykatës Supreme për AKP-në janë bërë dy pyetje:

1. Nëse palët ankuese kishin shprehur interesimin e tyre ligjor për pronën gjatë procedurës së kërkesës;

dhe:

2. Nëse ka shtëpi të ndërtuara në pronë, dhe nëse ka kur janë ndërtuar.

Faktet që burojnë prej memorandumit nga Shefi i AKP-së:

Lidhur me pyetjen e parë:

18. Nuk është dhënë asnjë përgjigje për pyetjen e parë.

Lidhur me pyetjen e dytë:

19. Sa i përket kërkesës KPA14555: Ka pasur objekte në ngastrat 172/1, 172/2, 173 dhe 174. Së paku bazuar në ortofotot e viteve 2000 dhe 2009. Sipas hartës kadastrale të vitit 1977, ka pasur objekte në ngastrat 172/2 dhe 173.

20. Sa i përket kërkesës KPA14556: Ka ekzistuar një objekt në ngastrën 175/4 sipas ortofotos të vitit 2000 dhe në ngastrat 175/4 dhe 175/2 sipas ortofotove të vitit 2009.

21. Nuk ka të dhëna tjera kadastrale më të hershme për këtë ngastër.

22. Në memorandumun e Shefit të AKP-së thuhet se njoftimet fizike të pronës më 17 prill 2008 përkatësisht 17 dhjetor 2008 janë konsideruar të pasakta dhe një vendim i marrë nga KKPK më datën 15 maj 2010, lidhur me AKP KPA14555 dhe AKP14556, si rrjedhojë është anuluar dhe lënda është kthyer në rishqyrtim.

Arsyetimi ligjor:*Pretendimet e palëve:**Pala ankuese:*

23. Palët ankuese kërkojnë anulimin e vendimit të KKPK-së dhe konfirmimin e pronësisë së tyre mbi pronën.

Për ta mbështetur ankesën e tyre, palët ankuese deklarojnë si në vijim:

- Palëve ankuese nuk iu kishte dhënë mundësia që të paraqiten para KKPK-së për t'i dhënë deklaratat e tyre;
- Vendimi i KKPK-së është marrë pa vërtetuar gjendjen reale faktike;
- Prona është shitur nga D. P. , babai i D. P., R. Z. R. Z. ia kishte shitur një pjesë të pronës S. S. G.;
-

- Pastaj në vitin 1973 babai i palëve ankuese S. R. kishte blerë (një pjesë) pronën e R. S. dhe të birit të tij H. Në vitin 1978 S. R. kishte blerë pjesën e mbetur të pronës nga S. S. G., duke u bërë kështu pronari i vetëm i pronës;
- S. R. i ka paguar DM 450.000 S. dhe DM 120.000 G.;
- Në kohën kur D. P. kishte shitur pronën ai jetonte në Pejë, ndërsa para kësaj jetonte në Pjeterq i Epërm;
- Në vitin 1983, babai i palëve ankuese kishte ndërtuar një shtëpi në pronë;
- Kjo shtëpi nuk ishte përfunduar para konfliktit të armatosur në periudhës 1998-1999 dhe ishte djegur nga forcat Serbe;
- Palët ankuese e kishin rinovuar shtëpinë pas konfliktit të armatosur dhe e tërë familja ka jetuar aty deri në vitin 2002;
- Në vitin 2002 palët ankuese ishin ndarë familjarisht. H. R. ka vazhduar të jetojë në shtëpinë e lartcekur, ndërsa dy vëllezërit e tij kishin ndërtuar shtëpitë e tyre në pronë në të cilat ende jetojnë.

24. Për t'i mbështetur deklaratat e tyre palët ankuese kanë paraqitur deklarata të dëshmitarëve të: A. R. M., R. R. R dhe A. Z. Z., në lidhje me blerjen e pronës nga babai si dhe deklaratat e H. R. Z. dhe S. S. G., sa i përket shitjes së pronës nga D. P.

Pala përgjegjëse në ankesë:

25. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ankesa është paraqitur pas afatit. Vendimi i KKPK-së është marrë më 26 tetor 2011 ndërsa ankesa është paraqitur më 16 tetor 2012, që nuk është brenda periudhës prej 30 ditësh të cekur në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

26. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se palët ankuese nuk kanë ndonjë të drejtë të paraqesin ankesë dhe prandaj nuk mund të jenë palë në procedurë. Palët ankuese nuk kanë qenë palë në procedurën e kërkesës pasi që ata nuk e kanë informuar Sekretarinë Ekzekutive për një fakt të tillë brenda 30 ditësh nga njoftimi sikurse parashihet me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

27. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar. Pronësia e tij ligjore mbi pronën është dëshmuar në tërësi me fletën poseduese nr. 14 dhe me Aktvendimin mbi trashëgiminë të Gjykatës Komunale në Pejë të datës 3 prill 1996 (nr.O.br.30/96) e konfirmuar nga

KKPK. Prandaj, pala përgjegjëse në ankesë kërkon që Gjykata Supreme ta vërtetojë vendimin e KKPK-së.

Pranueshmëria

28. Sipas nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk e ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.
29. Sikurse është shënuar në paragrafin 22 si më lartë, së paku njoftimi i parë i lëndës nuk është kryer si duhet. Prandaj, Gjykata Supreme i pranon palët ankuese në procedurë.
30. Palët ankuese janë të pranueshëm në ankesën e tyre pasi që ankesat janë paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh pasi vendimi i KKPK-së iu ishte dorëzuar atyre.

Juridiksioni

Ex officio:

31. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, një paraqitës kërkesë ka të drejtë për një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën pronësore por edhe se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
32. Palët ankuese deklaruan se ata janë në posedim, në fakt se ata janë pronarë që kur babai i tyre e kishte blerë pronën në vitin 1973. Palët ankuese dhe familja e tyre kanë jetuar në këtë pronë që nga ajo kohë. Provat e dhëna përbëhen nga dëshmitë e fshatarëve dhe fotografitë e gjendjes së mëparshme dhe të tashme.
33. Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi se ai është pronari i pronës me trashëgimi që nga viti 1996, i konfirmuar si i tillë më Aktvendimin mbi trashëgiminë të Gjykatës Komunale në Pejë të datës 3 prill 1996 (nr.O.br.30/96).
34. Aktvendimi bazohet në fletën poseduese nr.14 që është regjistruar në emër të nënës së palës përgjegjëse në ankesë. Dy kopjet e të njëjtës fletë poseduese që janë në dosje të lëndës kanë datën 16 shtator 2003 respektivisht 21 mars 2008. Ndërkaq, fleta poseduese e përdorur nga Gjykata Komunale në Pejë me sa duket kishte datën 30 janar 1996 por nuk është në dosje të

lëndës. Të dy fletat poseduese në lëndë ende e cekin nënën e ndjerë të palës përgjegjëse në ankesë si pronare të pronës.

35. Në aktvendim thuhet se edhe pala përgjegjëse në ankesë dhe nëna e tij e ndjerë jetonin në Pejë. Pra, ata nuk e kanë pasur shtëpinë në pronë. Në fakt, askund në dosje të lëndës nuk ka ndonjë shenjë nëse pala përgjegjëse në ankesë i ka ushtruar ndonjëherë të drejtat e tij pronësore.

Konkludim

36. Rrjedhimisht në të mësipërmen Gjykata Supreme konkludon se edhe sikur palët ankuese nuk do të ishin pronarët e pronës, uzurpimi i pronës nga palët ankuese dhe ndërtimi i shtëpisë së parë familjare ka ndodhur shumë kohë para konfliktit të armatosur të vitit 1997/1998. Kjo do të thotë se kjo lëndë nuk është nën juridiksionin e AKP-së por duhet të vendoset nga gjykata e rregullt.
37. Pasi që e lartcekura çon në vendimin ex officio, deklaratat tjera të palëve nuk do të çojnë në një vendim tjetër dhe prandaj nuk kanë nevojë për arsyetim.
38. Prandaj, vendimi i KKPK-së i datës 26 tetor 2011 sa i përket lëndëve AKP 14555 dhe AKP 14556 duhet të ndryshohet dhe kërkesat e paraqitura nga pala përgjegjëse në ankesë të hedhen poshtë si të palejueshme sipas dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpara (b) të Rregulores së UNMIKUut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Këshillë ligjore

39. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it